

Qendra për demokraci ekologjike Florozon

## VLERËSIM I NEVOJAVE

Për qasje të barabartë në drejtësi për raste lidhur me mjedisin jetësor



**Projekti:** Qasje e barabartë për drejtësi efektive

Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet skemës me grante “Fuqizim i ndikimit të shoqërisë civile për reforma efektive në jurisprudencë”

**Autorë:**

Gordana Nestorovska

Nenad Marković

Elica Paunovska

Ivan Petrovski

**Miruar nga:**

Kryetari i Qendrës për Demokraci Ekologjike FLOROZON

Kirill Ristovski

Shkup, 2019

Ky publikim është përgatitur me përkrahje nga Bashkimi Evropian, Përmbajtja, qëndrimet dhe mendimet janë përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk e pasqyrojnë qëndrimin e Bashkimit Evropian.

## Përmbajtja

Hyrje .....	3
Qasja metodologjike.....	4
Rezultate nga hulumtimi .....	5
Përdorim i mekanizmave ekzistues për qasje në drejtësi .....	19
Kapaciteti i institucioneve/organizatave dhe aktorëve tjerë të cilët punojnë me ndihmë juridike falas .....	24
Konkluzione dhe rekomandime.....	31
Rekomandime: .....	33
Literatura e konsultuar në lidhje me obligimet edhe të shtetit edhe të qytetarëve në lidhje me mjedisin jetësor .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## Hyrje

Vlerësimi i nevojave për ndërtim të mëtutjeshëm të kapaciteteve për qasje në drejtësi në fushën e mjedisit jetësor, është realizuar në periudhën maj-qershor të vitit 2019 në suaza të projektit **“Qasja e barabartë për drejtësi efektive”**. Projekti është implementuar nga *Shoqata qytetare Qendra për demokraci ekologjike FLOROZON nga Shkupi*, në partneritet me *Environmental Law and Management Association EMLA nga Hungaria*. Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet skemës me grante nga CFSD pranë Ministrisë për Financa – “Fuqizim i ndikimit të shoqërisë civile mbi reformat efektive në sektorin juridik”.

Projekti është në pajtim me Prioritetin 2 të thirrjes së lartpërmendur, ndërsa aksioni bazohet në konkluzionet e Strategjisë së re për reformë në sektorin gjyqësor (“Strategjia”) me Planin aksional 2017-2022, që është miratuar më 28 nëntor 2017 nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat korrespondojnë me Raportet e Komisionit Evropian për progresin e vendeve në vitet e fundit. Më konkretisht, projekti merret me përforsimin e kapaciteteve të organizatave në nivel lokal dhe nacional, si dhe të organeve relevante shtetërore në fushën e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut në mënyrë participuese dhe demokratike, nëpërmjet promovimit të mekanizmit për ndihmë juridike falas. Me implementimin e aksionit, përveç se do të përforsohen kapacitetet për përfaqësim të organizatave të synuara civile, do të kontribuohet edhe në implementimin e reformave në sistemin gjyqësor në vend. Përgjithësisht, ky aksion është dizajnuar t’i përgjigjet përparimit të përgjithshëm të reformave gjyqësore në vend dhe për të mundësuar kushte për arritjen e tyre në kontekst nacional. Arritja e qëllimeve të parapara do të bazohet përmes qasjej gjithëpërfshirëse, kryesisht duke vendosur bashkëpunim të fortë ndërmjet palëve të interesuara.

Qëllimi i hulumtimit për vlerësim të nevojave, është të merren informata për nivelin e identifikimit të problemeve nga ana e qytetarëve/organizatave civile dhe profesionistët të cilët i përfaqësojnë interesat e tyre, shkallën e informimit për të drejtat e qytetarëve dhe perceptimi i tyre për qasjen në drejtësi në pajtim me Konventën e Aarhusit, të cilën shteti e ka ratifikuar më vitin 1998. Njëkohësisht, hulumtimi duhet ta detektojë shkallën e shfrytëzimit të mekanizmave në dispozicion për qasje në drejtësi në fushën e mjedisit jetësor, si dhe ndihmën juridike falas, përkatësisht sa qytetarët dhe palët e interesuara si dhe publiku i ekspertëve, kanë kapacitet për të shfrytëzuar mekanizmat dhe qasjen në drejtësi në fushën e mjedisit jetësor.

Raporti i përpunuar do të kontribuon për ndërtim të mëtutjeshëm të kapaciteteve të të gjithë aktorëve në shoqëri në sigurimin e qasjes efektive në drejtësi nga fusha e mjedisit jetësor. Veç kësaj, raporti duhet të shërben edhe si vegël për monitorim të mëtutjeshëm dhe përfaqësim nga ana e organizatave joqeveritare të cilat punojnë në çështje për respektimin e të drejtave lidhur me mjedisin jetësor që duhet të kontribuojë edhe për përmirësimin e gjendjes faktike me mjedisin jetësor në nivel nacional dhe global.

## Qasja metodologjike

Qasja metodologjike në të cilën bazohet raporti është cilësore dhe kuantitative. Në suaza të qasjes cilësore analizohen dokumentet kyçe (strategji dhe plane aksionare) dhe ligje n fushën e të drejtave të njeriut, qasje në drejtësi, ndihmë juridike falas, mbrojtje e mjedisit jetësor. Grumbullimi dhe analiza e të dhënave sekondare është bërë në bazë të analizës së dokumenteve kyçe të përmendura më lart. Krahas analizës fillestare të rregullores ekzistuese ligjore, të dhënat ekzistuese sekondare dhe elaborimi i rezultateve nga raportet ekzistuese dhe hulumtimet e realizuara, pasqyra do të kompletohet me metodologjinë e dizajnuar e cilat duhet ta përcaktojë nyjen/ngushticat në qasjen në drejtësi për rastet nga fusha e mjedisit jetësor.

Grumbullimi i të dhënave primare është përbërë nga të dhënat e fituara nëpërmjet organizimit të dy grupeve të fokusit me 28 pjesëmarrës. Në grupin e parë të fokusit kishte pjesëmarrës nga gjyqësori, avokatia dhe organizatat civile, përkatësisht dhënës të ndihmës juridike falas, pastaj organizata që sigurojnë ndihmë juridike dhe organizata që punojnë në fushën e mjedisit jetësor. Në grupin e dytë të fokusit kishte pjesëmarrës nga organizatat civile si dhënës të ndihmës juridike falas dhe organizata të cilat sigurojnë ndihmë juridike, organizata që punojnë në fushën e mjedisit jetësor si dhe përfaqësues nga fakulteti juridik.

Diskutimi i fokus grupeve është mbajtur në bazë të panelit që ishte i ndarë në tre pjesë. Pjesa e parë kishte të bëjë me informim të pjesëmarrësve në intervistë lidhur me çështje që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, njoftim me Konventën e Aarhusit të cilën shteti jonë e ka ratifikuar, legjislacioni nacional në fushën e mjedisit jetësor, informim për aktivitetet e institucioneve për çështjet/problemet lidhur me mjedisin jetësor. Pjesa e dytë e informimit lidhur me ndihmën juridike falas, mënyrë e shfrytëzimit të ndihmës juridike falas, mundësi për aplikim të mekanizmit për raste lidhur me mjedisin jetësor për të cilat qytetarët duhet t'u drejtohen institucioneve kompetente dhe/ose gjykatave kompetente. Pjesa e tretë ishin çështje që ndërlidhen me kapacitetet dhe aktivitetet e institucioneve në lidhje me mjedisin jetësor dhe ndihmën juridike falas.

Të dhënat primare të cilat janë siguruar me grupet e fokusit janë përfshirë dhe analizuar në këtë raport.

Në kuadër të qasjes kuantitative si vegël janë përdorur 30 pyetësorë për intervistim, me 38 pyetje të ndara në pjesë hyrëse dhe tre fusha tematike. Grupi i parë i pyetjeve (gjithsej 13 pyetje) kanë të bëjnë me informata të përgjithshme për profilin, gjininë, moshën, statusin dhe profesionin si dhe institucionin nga i cili vijnë të intervistuarit të cilët i kanë plotësuar pyetësorët. Pjesa e dytë e pyetësorit (8 pyetje) ka të bëjë me identifikim të problemeve dhe informim lidhur me legjislacionin nacional nga fusha e mjedisit jetësor, si dhe mekanizmat e standardet ndërkombëtare nga kjo fushë, si dhe konventa e Aarhusit. Pjesa e tretë e pyetësorit (9 pyetje) ka të bëjë me përdorimin e mekanizmave ekzistues për qasje në drejtësi për raste që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor. Pjesa e katërt e pyetësorit (8 pyetje) i përmban përgjigjet e të intervistuarve për kapacitetin e institucioneve/organizatave dhe të aktorëve tjerë të cilët punojnë me ndihmë juridike falas. Struktura e pyetësorit është paraqitur në shtojcën 2.

Pyetësi është i dizajnuar që të njëjtin të mund ta plotësojnë më shumë palë të interesuara në këtë rast, më të interesuarit – nga njëra anë ministritë kompetente dhe shërbimet inspektuese, në anën tjetër qytetarët, avokatët, komuniteti akademik dhe organizatat civile si përfaqësues të qytetarëve. Në atë drejtim, pyetësi është dërguar në qindra e-mail adresa të përfaqësuesve të Trupit koordinues të formuar në suaza të projektit, organizata joqeveritare, të identifikuara paraprakisht, të cilat punojnë edhe në fushën e të drejtave të njeriut në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe ekologji, ekspertë të pavarur dhe profesorë me të cilët kemi bashkëpunim, avokatë të cilët kanë marrë pjesë në grupet e fokusit dhe përfaqësues të Ministrisë për drejtësi dhe të Ministrisë për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, si dhe në inspektoratet kompetente.

Pjesëmarrja në këtë hulumtim ishte anonime dhe në bazë vullnetare, përkatësisht hulumtimi garanton që, për të marrë të dhënat të besueshme, identiteti personal i të intervistuarit nuk do të zbulohet.


## Rezultate nga hulumtimi

Para se të fillojmë t'i analizojmë treguesit (indiktorët) dhe ndryshoret që duhet të na çojnë deri në identifikim të nevojave për ndërtim të kapaciteteve për qasje në drejtësi, në fushën e mjedisit jetësor, do të bëjmë një përmbledhje të strukturës së mostrës që ishte bazë për hulumtimin.

Nga gjithsej 30 të intervistuar, të cilët janë përgjigjur në pyetësin, më tepër se gjysma, përkatësisht 17 persona apo 56.7% janë gra, ndërsa 13 persona apo 43.3% janë meshkuj (shih grafikun 1).

Grafiku 1: Struktura e të intervistuarve të cilët janë përgjigjur, të ndarë sipas gjinisë

Struktura sipas gjinisë së të intervistuarve




Megjithëse janë përfshirë persona në moshë madhore nga të gjitha moshat (18 – 64 vjeç), numri më i madh i të intervistuarve janë në moshën prej 31-40 vjeç (12 persona), nëntë janë në

moshën prej 41-50 vjeç, pesë në moshën prej 51-64 vjeç, ndërsa 4 të tjerët 4 janë në moshën prej 18-30 vjeç (shih grafiku 2).

Grafiku 2: Strukturë e të intervistuarve të cilët janë përgjigjur në pyetësor të ndarë sipas grupit të moshave


Struktura e të intervistuarve sipas moshës




Sipas vendbanimit, pjesa më e madhe e të intervistuarve (29 nga gjithsej 30 të intervistuar jetojnë në qytet (mjedis urban), kurse vetëm 1 (një) pjesëmarrëse është me vendbanim në fshat (mjedis rural), është paraqitur në grafikun 3.

Grafiku 3: Strukturë e të intervistuarve sipas vendit të banimit

Vendi i banimit




Shkalla e arsimit të të intervistuarve është paraqitur më poshtë në grafikun 4:



Nga të dhënat e fituara prej të intervistuarve sa i përket arsimit të tyre, janë fituar këto të dhëna: ndër të intervistuarit nuk ka persona vetëm me arsim fillor, me arsim të mesëm (gjimnaz) ose pa arsimim. Pjesa dërmuese e tyre janë me arsim të lartë madje 16 të intervistuar, ka 7 magjistra dhe 4 persona të cilët janë me titull doktorë të shkencave.

Nga numri i përgjithshëm i të intervistuarve, **në ndonjë organizatë civile punojnë gjithsej 17 nga të intervistuarit apo 56.7%**, ndërsa në institucion ose organ publik/shtetëror punojnë 6 të intervistuar (20%), në gjyqësor/prokurori punon 1 (një) i intervistuar (3.3%). Në zyrë avokatie punojnë 2 (dy) të intervistuar (6.7%), ndërsa nga një i intervistuar punon në Universitetin Shën Cirili dhe Metodi në Shkup (tjerë) (3.3%), person i vetëpunësuar (3.3%), person i papunësuar (3.3%) dhe student (3.3%), është paraqitur në grafikun 5 më poshtë.

Grafiku 5: Strukturë e të intervistuarve sipas sektorit të punësimit






Sipas të dhënave të fituara, deri 56.7% e të intervistuarve janë të punësuar në organizatë civile, pas tyre me 20% janë të intervistuarit të cilët punojnë në institucion përkatësisht organ publik/shtetëror.

Struktura e të intervistuarve sipas nivelit të menaxhimit (pozita në organizatën/institucionin) është si vijon:

- A) punonjës shtetëror/drejtor/menaxher – 6 të intervistuar
- B) udhëheqës i sektorit/seksionit/programit – 6 të intervistuar
- C) praktikant/vullnetar - 4

D) të tjerë: pronar (1 pjesëmarrës), avokat (2 pjesëmarrës), kontrollor në eko patrullë (1 pjesëmarrës), koordinator projekti (2 pjesëmarrës), menaxher (1 pjesëmarrës), jurist (1 pjesëmarrës), kryetar shoqate (2 pjesëmarrës), asistent projekti (1 pjesëmarrës), profesor (2 pjesëmarrës), student (1 pjesëmarrës).

Grafiku 6: Struktura e të intervistuarve sipas nivelit të menaxhimit



Institucioni/organizata nga e cila vijnë të intervistuarit veprojnë në këto fusha (me mundësi për t'u rumbullakuar më tepër përgjigje):

- A) ndihmë juridike falas – 6 pjesëmarrës
- B) mjedisi jetësor– 13 pjesëmarrës
- C) të drejta të njeriut (promovim, trajnime dhe ngjashëm) – 12 pjesëmarrës


D) punë me grupe të lëndueshme (gra, fëmijë, persona me hendikep, bashkësi të marginalizuara dhe ngjashëm) – 7 pjesëmarrës

E) punë me grupe në rrezik social (sh.: persona që jetojnë në varfëri, romë, minoritete etnike) – 10 pjesëmarrës

- F) punë me fëmijë dhe të rinj – 10 pjesëmarrës
- G) punë me popullatë nga mjediset rurale – 7 pjesëmarrës
- H) tjera: përfaqësim të shoqatave – 1 pjesëmarrës.

Një i intervistuar nuk është përgjigjur në këtë pyetje.

Grafiku 7: Institucioni/organizata prej ku vijnë të intervistuarit



Në pyetjen: A ka në organizatën/institucionin Tuaj të punësuar të cilët sigurojnë ndihmë juridike (falas)? – 21 të intervistuar kanë dhënë përgjigje negative, 7 të intervistuar janë përgjigjur që ka 1-5 punonjës të cilët japin ndihmë juridike falas nga të cilët 5 janë nga sektori joqeveritar, ndërsa dy përgjigje pozitive janë nga institucionet publike/shtetërore, një (1) i intervistuar është përgjigjur që në organizatë/institucion ka më tepër se 5 persona të cilët japin ndihmë juridike falas dhe një i intervistuar nuk është përgjigjur në këtë pyetje (shih tabela 1).

Tabela 1: Numri i personave në organizatë/institucion të cilët punojnë me ndihmë juridike falas

A ka në organizatën/institucionin Tuaj të punësuar të cilët sigurojnë ndihmë juridike (falas)?	nuk ka	1-5	Mbi 5	Nuk është përgjigjur	Gjithsej
Gjithsej	21	7	1	1	30
%	<b>72.4%</b>	24.1%	3.4%	3.4%	100%

Vetëm 3, nga të intervistuarit të cilët kanë dhënë përgjigje pozitive që ka të person të punësuar që siguron ndihmë juridike falas, janë përgjigjur që kanë prej 1-5 punonjës të cilët punojnë në pjesën e dhënies së ndihmës juridike falas për **mjedis jetësor**.

Në pyetjen: Çfarë lloj shërbimesh siguron institucioni/organizata Juaj? – janë dhënë këto përgjigje:

- A) hulumtime dhe analiza – 6 (gjashtë) të intervistuar
- B) këshilla juridike dhe ndihmë juridike – 5 (pesë) të intervistuar
- C) krijim të politikave në nivel lokal/nacional – 2 (dy) të intervistuar
- D) serviser (përfaqësim në gjyq, ndërmjetësi dhe ngjashëm) – 1 (një) i intervistuar
- E) edukim dhe ngritje të vetëdijes – 13 (trembëdhjetë) të intervistuar

F) të tjerë: presion publik mbi institucionet, ngritje të vetëdijes së publikut për problemet – 1 (një i intervistuar), Këmbim të pajisjes sterile për injektim ndërmjet **IKD-ve**, edukime dhe ngritje të vetëdijes dhe tjera – 1 (një) i intervistuar.

Nga përgjigjet rezulton që pjesa më e madhe e të intervistuarve punojnë në edukim dhe ngritje të vetëdijes (43,3%), në hulumtime dhe analiza (20%) dhe këshilla juridike dhe ndihmë juridike (16,7%) nga të intervistuarit (shih grafikun 8).

Grafiku 8: Lloji i shërbimeve të cilat i siguron organizata/institucioni

### Lloji i shërbimeve të cilat i siguron organizata/institucioni juaj




Tabela 2: Nivel i punës së institucioneve/organizatave: në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar:

Nivel i punës	lokal	nacional	ndërkombëtar	gjithsej
Gjithsej	9	17	4	30
%	30%	56.7%	13.3%	100%

Pjesa më e madhe e atyre që janë përgjigjur në pyetësonin punojnë në nivel nacional (56,7%), pastaj në nivel lokal (30%) dhe pjesa më e vogël në nivel ndërkombëtar (13,3%) apo vetëm 4 nga të intervistuarit.


### Identifikim i problemeve dhe informimi në lidhje me mjedisin jetësor

Duke e pasur parasysh që projekti merret me forcim të kapaciteteve të organizatave lokale dhe nacionale si dhe të organeve relevante shtetërore që punojnë në fushën e qasjes në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor, kjo pjesë e pyetësonit ka të bëjë me identifikimin e problemeve lidhur me qasjen në drejtësi dhe informim që ndërlidhet me legjislacionin nacional nga fusha e mjedisit jetësor, mekanizmat ndërkombëtar dhe standardet nga kjo sferë si dhe në lidhje me informimin me Konventën e Aarhusit.

Në pyetjen: A jeni të informuar për çështjet të cilat i rregullon Konventa e Aarhusit, e ratifikuar nga shteti jonë më vitin 1999? – dy të tretat ose 20 të intervistuar janë përgjigjur në mënyrë afirmative, që është 66.7%, nëntë (9) përkatësisht 30% e të intervistuarve janë përgjigjur me “jo”, kurse një (1) i intervistuar (3.3%) nuk është përgjigjur në këtë pyetje (e paraqitur në grafikun 9).

Grafiku 9: Informim për Konventën e Aarhusit

#### Informim për çështje të cilat i rregullon Konventa e Aarhusit




*Përgjigjet për këtë çështje korrespondojnë me përgjigjet nga grupet e fokusit ku numër shumë i vogël i të intervistuarve kanë dëgjuar për Konventën e Aarhusit edhe atë kryesisht përfaqësuesit e sektorit joqeveritar dhe përfaqësuesit e institucioneve të cilët drejtpërsëdrejti punojnë me çështje lidhur me mjedisin jetësor.*

Në pyetjen: A jeni të njoftuar me standardet dhe mekanizmat ndërkombëtar të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut i ka ratifikuar në fushën e mjedisit jetësor? Përgjigje pozitive kanë dhënë 13 të intervistuar (43.3%), ndërsa negative 17 (56.7%). Kjo tregon që më tepër se gjysma e të intervistuarve nuk janë të njoftuar me standardet dhe mekanizmat ndërkombëtar në fushën e mjedisit jetësor të cilat shteti jonë i ka ratifikuar.

Nga ata të cilët kanë dhënë përgjigje pozitive, së paku<sup>1</sup> nëntë (9) përgjigje janë nga përfaqësues të sektorit joqeveritar me çka edhe një herë konfirmohet që përfaqësuesit e sektorit joqeveritar janë më të informuar në lidhje me obligimet ndërkombëtare të shtetit.

Grafiku 10: Njohuri për standarde dhe mekanizma ndërkombëtar të ratifikuar në fushën e mjedisit jetësor



Përqindja e lartë e përgjigjeve negative (56,7%) përputhet me përgjigjet nga grupet e fokusit ku të pranishmit përveç Konventës së Aarhusit, nuk mund të numëronin standardet dhe mekanizma konkret ndërkombëtar nga fusha e mjedisit jetësor që janë ratifikuar nga shteti jonë.

Pjesëmarrësit, të cilët në pyetjen paraprake janë përgjigjur pozitivisht, si standarde dhe mekanizma ndërkombëtarë të cilat shteti jonë i ka ratifikuar në sferën e mjedisit jetësor, si të njohura i kanë përmendur:

- E drejta e qytetarëve për informim, e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në vendimmarrje për mjedisin jetësor, e drejta për mbrojtje juridike në rast kur dy rregullat paraprake janë shkelur.
- Konventa e Aarhusit, Konventa për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor në kontekst ndërkufitar
- Konventa e Aarhusit, Marrëveshja Klimatike e Parisit, Kioto Protokolli, Konventa Kornizë e OKB-së
- Procesi i organizimit të Qendrës Aarhus
- Emetimi i gazrave
- Konventa për ujë dhe ajër
- Qasje tek informatat nga fusha e mjedisit jetësor, pjesëmarrje në opinion në vendimmarrje, qasje në drejtësi
- Protokolli Kioto

<sup>1</sup> Numri i saktë nuk mund të përcaktohet për shkak se të gjithë të intervistuarit nuk kanë dhënë përgjigje ku punojnë


- Të gjitha instrumentet për të drejtat e njeriut
- Ligji për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor dhe natyrës, Direktiva për vlerësim të efekteve nga projekte të caktuara publike dhe private mbi mjedisin jetësor dhe ndryshim e plotësim të Direktivës për vlerësim të efekteve nga disa plane dhe programe mbi mjedisin jetësor; Direktiva për parandalim të integruar dhe për kontroll të ndotjes; Direktiva për qasje të publikut tek informatat nga sfera e mjedisit jetësor dhe shfuqizim i Direktivës 90/313; Direktiva për pjesëmarrje të publikut në lidhje me miratimin e draft planeve dhe programeve të caktuara që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor dhe ndryshime e plotësim në lidhje me pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen në drejtësi; Direktiva për kontroll të rreziqeve nga kanosjet prej avarive me prani të substancave të rrezikshme;
  - AAarhusi- qasje në informata, pjesëmarrje e publikut gjatë vendimmarrjes, qasje në drejtësi (megjithëse nuk e kemi të qartë si konkretisht kjo pjesë me AAarhus-in, qasja në drejtësi), në lidhje me mjedisin jetësor. Konventat e ratifikuara ndërkombëtare – e Bernit, Bonit, Ramsarit, Rios, Stokholmit, Roterdamit, Minamas, Bazelit, kundër shkretërimit, protokollit nga Kioto, Korniza për ndryshime klimatike, ndotja ndërkufitare, Konventa Evropiane për peizazhin, UNESCO trashëgimi botërore natyrore dhe kulturore...

*Përgjigja në këtë pyetje edhe një herë vërteton që vetëm pjesë e vogël e të intervistuarve kanë njohuri konkrete për standardet dhe mekanizmat ndërkombëtar në sferën e mjedisit jetësor, ndërsa të tjerët janë të informuar që shteti ka disa obligime, mirëpo nuk i dinë dokumentet konkrete ndërkombëtare.*

Në pyetjen: A jeni të njoftuar me legjislacionin nacional nga sfera e mjedisit jetësor? – Përgjigje pozitive kanë dhënë 15 të intervistuar (53.6%), përgjigje negative 13 të intervistuar (41%), 2 nuk janë përgjigjur në këtë pyetje (7%), është paraqitur në grafikun 11.

Grafiku 11: Njohje e legjislacionin nacional të Maqedonisë nga sfera e mjedisit jetësor

### Njohje e legjislacionit nacional të Maqedonisë nga sfera e mjedisit jetësor



Gjysma e pjesëmarrësve konsiderojnë që kanë njohuri lidhur me legjislacionin nacional të Maqedonisë nga fusha e mjedisit jetësor, ndërsa gjysma tjetër konsideron që nuk kanë njohuri lidhur

me legjislacionin nacional nga sfera e mjedisit jetësor. Nga ata të cilët janë të njoftuar, dhjetë (10) janë përfaqësues të sektorit joqeveritar.

Ata të cilët kanë dhënë përgjigje pozitive në pyetjen paraprake, për cilat ligje të legjislacionit nacional janë të njoftuar në sferën e mjedisit jetësor, i kanë përmendur këto:

- Konventa e Aarhusit
- Ligji për mjedis jetësor, cilësi të ajrit ambiental, mbrojtje të natyrës, mbrojtje nga zhurma, menaxhim të mbeturinave, menaxhim me paketime dhe mbeturinat të paketimeve, ujëra
- Ligji për ajër ambiental
- Ligji për ajër, mjedisi jetësor, mbeturina etj
- Ligji për mjedis jetësor
- Ligji për mjedis jetësor, Ligji për menaxhim të mbeturinave dhe Ligji për natyrën
- Ligji për mjedis jetësor, për mbrojtje të natyrës, për cilësi të ajrit ambiental, për menaxhim të mbeturinave, për ujëra, për planifikim hapësinor dhe urbanistik, për OGJM, për mbrojtje nga zhurma
- Ligji për mjedis jetësor, Ligji për mbrojtje të natyrës
- Ligji për mjedis jetësor, Ligji për menaxhim me hedhurina, Ligji për peshkim, Ligji për gjueti, Ligji për ujëra, Ligji për mbrojtje të natyrës, Ligji për zhurmë, Ligji për tokë, Ligji për cilësi dhe siguri të plehrave, etj.
- Ligji për mbrojtje të natyrës, Ligji për ujëra, Ligji për menaxhim me hedhurina dhe Ligji për cilësi të ajrit ambiental
- Shumica e ligjeve për mjedis jetësor

Pjesa më e madhe e përmendin Ligjin për mbrojtje të mjedisit jetësor, Ligjin për mbrojtje të natyrës, Ligjin për mbrojtje nga pirja e duhanit, Ligji për mbrojtje nga zhurma, Ligji për gjelbërim, Ligji për menaxhim të mbeturinave, Ligji për rregullim hapësinor dhe urbanistik e tjera.

Këto përgjigje përputhen me përgjigjet e grupeve të fokusit me atë që në grupet e fokusit të intervistuarit kanë theksuar që: “ligjet janë në rregull, problemi është që aspak nuk zbatohen as në nivel lokal, as në nivel nacional, duke filluar nga hedhja e mbeturinave gjithandej dhe gjithçka tjetër, kundërvajtësit nuk dënohen dhe nuk ekziston përgjegjësi për ndotjen e mjedisit jetësor. Profesionistët nga fusha e mjedisit jetësor nuk i thërret askush, as që dikush i konsulton për çështje të rëndësishme. Profesorët të cilët merren me këtë problematikë askush nuk i konsulton, vetëdija te popullata është në nivel shumë të ulët, ndërsa në anën tjetër është e diskutueshme sa efikase është NP për pastërti dhe gjelbërim”.

Në pyetjen: A konsideroni që keni mjaftueshëm informata për aktivitetet e institucioneve për çështjet/problemet lidhur me mjedisin jetësor? – Vetëm 20 % përkatësisht 6 të të intervistuarve janë përgjigjur me “po, rregullisht ndjek informata për temën” kurse 76.7% përkatësisht 23 të intervistuar janë përgjigjur me: “jo, nuk kam informata, mirëpo do të doja”. Me “jo, as nuk më intereson” është përgjigjur një i intervistuar (3.3%). Përgjigjet për këtë çështje janë paraqitur në tabelën 3.

Tabela 3: Informim për aktivitetet e institucioneve për çështje/probleme lidhur me mjedisin jetësor

A konsideroni që keni mjaftueshëm informata për aktivitetet e institucioneve për çështjet/problemet lidhur me mjedisin jetësor?	po, rregullisht i ndjekni informatat për temën	jo, nuk kam informata, mirëpo do të doja	jo, as nuk më intereson	gjithsej
gjithsej	6	23	1	30
%	20%	76.7%	3.3%	100%

Përgjigja në këtë pyetje përputhet me përgjigjet edhe nga fokus grupet, për shkak se pjesa më e madhe (23 të intervistuar) përkatësisht 76,7% të të intervistuarve nuk kanë mjaft informata për çështjet/problemet lidhur me mjedisin jetësor. Prej atyre gjashtë (6) të intervistuar të cilët kanë dhënë përgjigje pozitive, katër (4) janë nga sektori joqeveritar, ndërsa dy (2) janë nga sektori shtetëror/publik. Në grupet e fokusit është theksuar “nëse ndonjë person është mjaft këmbëngulës dhe i interesuar, atëherë do të vjen deri te informata. Të tjerët konsiderojnë që informatat aspak nuk vijnë deri te qytetarët dhe nuk janë të dukshme. Nevojiten informata për nivelin e ndotjes, cilat masa ndërmerren nga organet kompetente, dinamika e zbatimit dhe konstatime nga revidimi i masave të zbatuara, informata për gjendjen e mjedisit jetësor lokal, informata për cilësinë e ujit, ajrit dhe ushqimit si dhe informata për mjedisin jetësor në përgjithësi”. Si shembull pozitiv pjesëmarrësit në grupet e fokusit e kanë theksuar publikimin e PDU-ve në ueb faqen e komunave me çka vihet në dispozicion të publikut për ta parë gjatë tre muajve, mirëpo kjo bëhet vetëm pasi të kalojë afati i qytetarëve për të reaguuar, përkatësisht atë e bëjnë tepër vonë, megjithëse u është dhënë mundësi me kohë t’i japin vërejtjet.

Në pyetjen: A keni marrë pjesë deri më tani si qytetar/e apo si përfaqësues nga institucioni/organizata juaj në debat publik për tema lidhur me mjedisin jetësor të organizuara nga ndonjë institucion/organizatë? (të intervistuarit kanë pasur mundësi të rrethojnë më shumë përgjigje. Janë dhënë këto përgjigje:

a) PO, në debatin e organizuar nga ana e komunës – 4 të intervistuar

b) PO, në debatin e organizuar nga ana e institucionit në nivel nacional (Qeveria, Ministria për mjedis jetësor, Inspektorat për mjedis jetësor dhe ngjashëm) – 6 të intervistuar,


c) PO, në debat të organizuar nga ana e organizatës civile/qytetarëve – 11 të intervistuar,

d) JO, asnjëherë – 9 të intervistuar.

Përgjigjet për pyetjen janë paraqitur në grafikun 12.




Grafiku 12: Pjesëmarrje në debate publike lidhur me mjedisin jetësor



Dy të tretat e të intervistuarve kanë marrë pjesë në ndonjë debat për tema lidhur me mjedisin jetësor edhe atë më së shpeshti në debate të organizuara nga sektori joqeveritar. Në grupet e fokusit pjesëmarrësit kanë theksuar që “duhet të hapen debate publike për deponitë rajonale të cilat duhet të ndërtohen (ajo në Shën Nikole)” partneritetet publik-privat për deponitë, zonat industriale dhe zhvendosja e tyre (Birraria, Çimentorja Usje të cilat më parë kanë qenë jashtë zonave të banuara, mirëpo sot zonat rreth tyre janë të banuara me popullatë të dendur), si dhe për çështje lidhur me PDU, planifikimi hapësinor dhe jeta humane, ndotja e ajrit dhe e tokës si dhe të gjitha çështjet nga sfera e mjedisit jetësor të cilat e prekin qytetarin në përgjithësi. Duhet të ngritet edhe çështja sa është shkaktar i madh i ndotjes së ajrit ngrohja me dru e sa me peleta. Cilësia e ujit për pije është çështje gjithashtu e rëndësishme, çka donë të thotë klori dhe guri gëlqeror dhe si ndikojnë në shëndetin e njeriut.”. Në grupin tjetër kanë theksuar: “duhet të ketë debate tematike për shkatërrimin e pyjeve, problemin me rrëshqitjet e dheut, autostradat me ndërtimin e të cilave shkatërrohen zonat malore, minimi joadekuat në Kozjak me çka është rrezikuar burimi Treska. Debate të rregullta janë të nevojshme për temat në vijim: planifikim hapësinor, miniera, ajri, shëndeti i njerëzve dhe ndotja, riciklimi i hedhurinave.”

Ata që janë përgjigjur negativisht në pyetjen paraprake, si shkaqe për mospjesëmarrje në diskutime tematike i kanë dhënë këto përgjigje: gjashtë (6) nga të intervistuarit janë përgjigjur që nuk kanë informata kur organizohen ngjarje të këtilla, dy (2) të intervistuar janë përgjigjur që nuk ka aktivitete të atilla në mjedisin e tyre, një (1) është përgjigjur që nuk është i interesuar të viziton ngjarje të tilla, një (1) i intervistuar është përgjigjur që nuk ka kohë, megjithëse do të kishte dashur, një (1) i intervistuar nuk ka dhënë asnjë përgjigje.


Grafiku 13: Shkaqe për mospjesëmarrje në debate publike



Nga kjo rezulton se qytetarët (pavarësisht se ku janë të punësuar) kanë nevojë për të pranuar informata me kohë për të gjitha çështjet lidhur me mjedisin jetësor, e të cilat ndikojnë në jetën dhe shëndetin e tyre.

Në pyetjen: A konsideroni që ekzistojnë probleme/çështje nga sfera e mjedisit jetësor për të cilat qytetarët duhet të drejtohen në institucionet kompetente dhe/ose gjykatat kompetente? – Pjesa më e madhe e të intervistuarve përkatësisht gjithsej 28 prej tyre (madje 93.3%) janë përgjigjur me “po”, ka shumë probleme të tilla”, 3.3 % prej tyre (1 i intervistuar) është përgjigjur me “po, megjithëse nuk ka shumë prej tyre”, dhe 3.3% përkatësisht 1 i intervistuar është përgjigjur që nuk di nëse ekzistojnë probleme dhe çështje të tilla (shih grafikun 14).

Grafiku 14: Çështje dhe probleme nga sfera e mjedisit jetësor



Me këtë edhe një herë konfirmohet që qytetarët kanë nevojë për njohje të mekanizmave për mbrojtje gjatë shkeljes së ndonjë prej të drejtave lidhur me mjedisin e shëndoshë jetësor. Në grupet e fokusit është theksuar: “Deri tani asnjë nga avokatët e pranishëm nuk ka pasur rast nga sfera e mjedisit jetësor, as nuk ka dëgjuar për ndonjë rast të tillë që është mbajtur në këtë shtet. Deri tani janë hapur çështje lidhur me urbanizmin, por jo edhe me segmente tjera të mjedisit jetësor dhe për fat të keq çdo herë në fund përfundon me protestë, debat dhe asgjë më tepër. Përvoja me kompensim të dëmit tregon që (shembull: qytetarë të kafshuar nga qentë) fillohet nga e para me aktpadi masive, mirëpo, shteti, për ta mbrojtur interesin e vet dhe për të ndalur derdhjen e parave nga buxheti i ndryshon ligjet ekzistuese në dëm të qytetarëve.... Në gjyqësorin tonë, taksat gjyqësore dhe ekspertizat janë shumë të shtrenjta, pavarësisht për çfarë lënde bëhet fjalë dhe gjendja e këtyllë në pjesën dërmuese të rasteve i kthen qytetarët nga qëllimi për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre në gjykatë. Gjykatësit duhet ta njohin materien për të cilën vepron, në gjykatën civile gjithçka përfundon në kompensim të dëmit, ndërsa procedurat janë tepër të shtrenjta, gjykatësit nuk janë të edukuar për të vepruar në raste kur ndodh cenim i shëndetit që është shkaktuar nga shkaqe ekologjike.”

Në grupin e fokusit është theksuar edhe se qytetarët nuk duhet të reagojnë individualisht, por vet institucionet kanë për obligim të reagojnë gjatë gjendjeve të tilla, për shkak se individ nuk ka as kohë, as mjete për atë. Në anën tjetër, ekziston edhe mosbesim në sistem, për shkak se çdoherë kur duhet të fillon ndonjë procedurë apo proces, ky paraqet lavirinth pa fund.

Në pyetjen (numër 8): A jeni të njoftuar me kushtet për shfrytëzim të ndihmës juridike falas në pajtim me Ligjin për ndihmë juridike falas? – 20 të intervistuar (66.7%) janë përgjigjur me po, 10 të intervistuar, përkatësisht 33.3% kanë dhënë përgjigje negative (shih tabela 4).

Tabela 4: Kushtet për shfrytëzim të ndihmës juridike falas në pajtim me Ligjin për ndihmë juridike falas

A jeni të njoftuar me kushtet për shfrytëzim të ndihmës juridike falas në pajtim me Ligjin për ndihmë juridike falas?	po	jo	gjithsej
gjithsej	18	12	30
%	66.7%	33.3%	100%

Duhet të përmendin që pyetësi është realizuar në kohë kur miratohej Ligji i ri për ndihmë juridike falas, ashtu që përgjigjet vlejnë për Ligjin e vjetër për ndihmë juridike falas. Numri më i madh i të intervistuarve 18 persona (66,7%) konsiderojnë se i njohin kushtet për ndihmë juridike falas. Prej tyre, pesëmbëdhjetë përgjigje janë nga sektori joqeveritar.

Në lidhje me këtë çështje, në grupet e fokusit është theksuar që: “dispozitat nuk respektohen, veçanërisht nëse është kontest me ndonjë ministri, institucion shtetëror... LNJK shfrytëzohet si pengesë, në 1% të rasteve lejohet ndihmë juridike falas, kurse ligji është i ndërlikuar, ndërkaq koncepti i tij është i gabuar. Është përmendur që në procedurën administrative ekziston dispozitë

sipas të cilës në rast të kontestit nga sfera e të drejtave sociale, pala është e çliruar nga pagesa e taksave gjyqësore.”

## Shfrytëzim i mekanizmave ekzistues për qasje në drejtësi

Pjesa e shfrytëzimit të **mekanizmave ekzistues për qasje në drejtësi** fillon me pyetjen: A dini ku të drejtoheni në rast të shkeljes së drejtës tuaj për mjedis jetësor të shëndoshë? Në këtë pyetje, 18 të intervistuar janë përgjigjur me po, ndërsa 12 me jo. Paraqitja tabelore e përgjigjeve është dhënë më poshtë, në tabelën 5.

TABELA 5: Ku të drejtoheni në rast të shkeljes së të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë

A dini ku të drejtoheni në rast të shkeljes së të drejtës tuaj për mjedis jetësor të shëndoshë?	po	jo	gjithsej
gjithsej	18	12	30
%	60%	40%	100%

Gjashtëdhjetë (60) përqind nga të intervistuarit (apo 18 të intervistuar) u përgjigjën që e dinë ku të drejtoheni në rast të shkeljes së të drejtës për mjedis jetësor. Prej tyre, 15 janë përfaqësues të sektorit joqeveritar. Në grupet e fokusit është theksuar që edhe institucionet (për shembull komunat) nuk dinë ku t’i udhëzojnë palët nëse kanë ndonjë problem. Si shembull është përmendur rast me zhurmë, kur është denoncuar problem në inspektoriat, inspektori ka konstatuar zhurmë, mirëpo nuk ka ndërmarrë masa për dënim të burimit të zhurmës, as që ka pasur mundësia të udhëzon palën në procedurë të mëtutjeshme.


Në pyetjen: A **keni pasur** nevojë deri tani të drejtoheni në ndonjë institucion/organizatë (në nivel nacional apo lokal) për çështje/probleme lidhur me mjedisin jetësor personalisht për juve apo klient? – Përgjigjet janë këto:

- a) PO, për mua personalisht – 5 të intervistuar (16.7%)
- b) PO, për klient – 5 të intervistuar (16.7%)
- c) JO, nuk kam pasur nevojë – 15 të intervistuar (50%)
- d) JO, nuk u besoj institucioneve – 2 të intervistuar (6.7%)
- g) JO – 3 të intervistuar (10%)

Përgjigjet për këtë pyetje janë paraqitur në grafikun 15.

Grafiku 15: Nevojë për t'iu drejtuar ndonjë institucioni/organizate (në nivel nacional apo lokal) për çështje/probleme lidhur me mjedisin jetësor personalisht për të intervistuarin apo për klient

### Nevoja për t'iu drejtuar ndonjë institucioni/organizati



Më tepër se 45% e të intervistuarve janë përgjigjur që deri tani nuk kanë pasur nevojë t'i drejtohen ndonjë institucioni/organizate (në nivel nacional apo lokal) për çështje/probleme lidhur me mjedisin jetësor personalisht për vete apo për klient. Ata që kanë dhënë përgjigje pozitive 32,4%, pavarësisht nëse për ata apo për klient, në pyetjen se në cilin institucion/organizatë jeni drejtuar, i kanë dhënë përgjigjet në vijim me ç'rast ka qenë mundësia të rumbullakohen më tepër se një përgjigje:

- a) Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor – 4 të intervistuar
- b) Institucion në komunën ku jetoj – 5 të intervistuar
- c) Inspektorati për mjedis jetësor/Inspektor/linjë telefonike – 7 të intervistuar
- d) Organizatë qytetare e cila punon në sferën e mjedisit jetësor – 3 të intervistuar
- g) Gjykatë kompetente – 1 të intervistuar

Pavarësisht që për këtë çështje ka dy përgjigje që **nuk janë drejtuar** në institucionet për shkak se nuk u besojnë, vetëm tre nga ata që janë drejtuar në ndonjë institucion/organizatë, janë drejtuar në organizatë joqeveritare, ndërsa 15 persona në institucion shtetëror/publik.

Në pyetjen: "A konsideroni se qytetarëve u është mundësuar qasje në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor, nëpërmjet mekanizmave ekzistues për qasje në drejtësi?" – Përgjigje pozitive kanë dhënë 5 të intervistuar, negativisht janë prononcuar gjithsej 22 të intervistuar, kurse nuk janë përgjigjur gjithsej 3 të intervistuar (shih tabela 6).

TABELA 6: Qasje e mundësuar në drejtësi nga sfera e mjedisit jetësor, nëpërmjet mekanizmave ekzistues për qasje në drejtësi

A konsideroni se qytetarëve u është mundësuar qasje në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor, nëpërmjet mekanizmave ekzistues për qasje në drejtësi?	po	jo	Nuk janë përgjigjur	gjithsej
Gjithsej	5	22	3	30
%	16.7%	73.3%	10%	100%

Nga ata që kanë dhënë përgjigje pozitive, tre janë përfaqësues të sektorit joqeveritar, një nga institucion publik, kurse për një përgjigje nuk kemi të dhëna cili është i intervistuari.

**Shqetëson fakti që përqindje e larta, 73.3% e të intervistuarve konsiderojnë që qytetarëve nuk u është mundësuar qasje në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor nëpërmjet mekanizmave ekzistues për qasje në drejtësi. Kjo flet për nevojën për të gjetur mekanizma adekuat dhe përkatës të adaptuar me qasjen në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor.**

Në fokus grupet është theksuar që problem i përgjithshëm është mungesa e harmonizimit të ligjeve dhe procedurave, përkatësisht në gjykata, për lëndë të ngjashme miratohen vendime të ndryshme. Për shkak të standardit të ulët të shtetit dhe varfërisë në rritje, qëndrimi është që taksat gjyqësore të ne duhet të jenë simbolike. Në praktikë ato janë tepër të larta, maksimalja është 96.000,00 denarë dhe nëse lënda arrin në gjykatën e apelit dhe gjykatë supreme, paguhet e njëjta shumë për secilën instancë dhe për çdo mjet të rregullt dhe të jashtëzakonshëm juridik. Për ato shkaqe, njerëzit nuk kërkojnë mbrojtje gjyqësore për të drejtat e tyre. Të pranishmit e kanë përmendur edhe që shuma e taksave gjyqësore qëllimisht është rritur konsiderueshëm, me qëllim të reduktohen kontestet gjyqësore..... Filtër para se gjithash duhet të jenë avokatët dhe taksat gjyqësore. Në pajtim me të përmendurën, avokatët duke e shfrytëzuar ekspertizën e tyre duhet t'i udhëzojnë palët cili është problemi juridike për të cilin mund të mbahet procedurë me kërkesë të palës dhe cili problem jetësor. Problemet juridike mbahen në procedura gjyqësore, që nuk është rast me problemet jetësore. Të gjithë vlerësojnë që me gjyqësorin ekzistues është vërtetë e vështirë të kërkohej drejtësi. Gjithashtu, u hap çështja nëse në përgjithësi ekzistojnë ekspertë të cilët mund të japin konstatim dhe mendim gjatë kontesteve nga sfera e mjedisit jetësor.”

Nga ata të cilët kanë dhënë përgjigje pozitive në pyetjen paraprake, përkatësisht ata që konsiderojnë që qytetarëve u është mundësuar qasje në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor, nëpërmjet mekanizmave ekzistues për qasje në drejtësi, i kanë përmendur këta mekanizma për qasje në drejtësi:


- Konventa e Aarhusit
- Organet e drejtorisë, inspektorati, Ministria, pastaj mbrojtje gjyqësore
- Parashtrim i iniciativës për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë pranë gjykatës kushtetuese, procedurë gjyqësore dhe administrative

Dy nga të intervistuarit të cilët janë përgjigjur me PO në pyetjen paraprake, për këtë nuk kanë dhënë përgjigje.

Në lidhje me mekanizmat për qasje në drejtësi është parashtruar edhe pyetja “a keni shfrytëzuar deri tani ndihmë juridike falas Ju ose dikush që e njihni dhe sa jeni të kënaqur nga institucionet e kyçura në proces?” – Me “PO”, tjetër kush dhe ka qenë shumë i/e kënaqur janë përgjigjur 4 të intervistuar, me “PO”, për mua personalisht dhe JO nuk jam i/e kënaqur, janë përgjigjur 2 të intervistuar, me “PO”, tjetër kush dhe JO nuk ka qenë i/e kënaqur, janë përgjigjur gjithsej 10 të intervistuar, me “JO”, asnjëherë është përgjigjur 1 (një) i intervistuar, ndërsa 13 të intervistuar aspak nuk janë përgjigjur (shih grafikun 16).

Grafiku 16: Shfrytëzim i mekanizmit ndihmë juridike falas

### A ka shfrytëzuar dikush ndihmë juridike falas dhe sa jeni të kënaqur nga institucionet e përfshira në atë proces



Në pyetjen “A konsideroni që nëpërmjet mekanizmit ndihmë juridike falas duhet të mundësohet qasje në drejtësi nga sfera e mjedisit jetësor?” – 28 të intervistuar (93,3%) kanë dhënë përgjigje pozitive, 1 negative, 1 nuk është përgjigjur në pyetjen (paraqitur në tabelën 7).

TABELA 7: Mundësim i qasjes në drejtësi nga sfera e mjedisit jetësor nëpërmjet mekanizmit për ndihmë juridike falas

A konsideroni që nëpërmjet mekanizmit ndihmë juridike falas duhet të mundësohet qasje në drejtësi nga sfera e mjedisit jetësor (nëse kërkuesi i plotëson kriteret për shfrytëzim të ndihmës juridike)?	Po	jo	pa përgjigje	gjithsej
gjithsej	28	1	1	30
%	93.3%	3.3%	3.3%	100

Kjo përgjigje përputhet edhe me përgjigjet e grupeve të fokusit ku është përmendur që qytetarët e varfër të cilët nuk kanë informata nuk e dinë se janë të sëmurë nga, të themi ajri, toka... ata temën e mjedisit jetësor e kanë të fundit, për shkak se nuk kanë kushte ekzistenciale për jetë. Sipas të intervistuarve, diskutabile është edhe cilësia e mbrojtjes shëndetësore, mjeku përcakton

diagnozë dhe jep terapi, mirëpo nuk mund të jep lidhjen shkaktar-pasojë ndërmjet sëmundjes dhe problemit nga mjedisi jetësor. Në Maqedoni për momentin nuk ka mënyrë për të vërtetuar rast të tillë që kërkon ekspertizë, procedurë të ndërlikuar, ndërsa rasti do të ishte në interes publik për të gjithë qytetarët.

Vlerësimet e institucioneve për mekanizmat ekzistues aktivë **për mbrojtjen** e të drejtave nga sfera e mjedisit jetësor dhe vepronjë për kërkesat e qytetarëve janë **(1 më i ulët - 5 më i lartë) janë paraqitur në tabelën 8:**

TABELA 8: Vlerësim i mekanizmave **për mbrojtjen** e të drejtave nga sfera e mjedisit jetësor dhe veprim sipas kërkesave të qytetarëve

	Mekanizmat për mbrojtje	1	2	3	4	5	Pa përgjigje	Vlerësim mesatar
a)	Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor	10 (33,3%)	14 (46,6%)	3 (10%)	1 (3%)	1 (3%)	1 (3%)	1,9
b)	Komuna/inspektorate komunale	7 (23,3%)	16 (53,3%)	3 (10%)	1 (3%)	2 (6,7%)	1 (3%)	2,13
c)	Inspektorati për mjedis jetësor	10 (33,3%)	10 (33,3%)	5 (16,7%)	2 (6,7%)	2 (6,7%)	1 (3%)	2,17
d)	Organizatë civile e cila siguron ndihmë juridike	0	3 (10%)	11 (36,6%)	11 (36,6%)	3 (10%)	2 (6,7%)	3,5


**Nga institucionet shtetërore/publike, vlerësimin më të dobët mesatar** e ka Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, pastaj Komuna/inspektoratet komunale (2,13) pastaj inspektorati për mjedis jetësor me vlerësim mesatar (2,17). Organizatat civile janë më së mirë të vlerësuara në krahasim me të gjitha subjektet paraprake me notë mesatare 3,5 që paraqet një notë më tepër në raport me subjektet më parë të përmendur.

Në pyetjen për perceptimet për bashkëpunim ndërmjet institucioneve të ndryshme, përkatësisht “Sa është i shpeshtë bashkëpunimi, nëse ka diçka të tillë, ndërmjet organizatave civile/qytetarëve dhe institucioneve në nivel lokal”, përgjigjet e të intervistuarve janë si vijon (shih grafikun 17):



Grafiku 17: frekuenca e bashkëpunimit ndërmjet faktorëve të ndryshëm

### Sa i shpeshtë është bashkëpunimi, nëse i njëjti ekziston



Përgjigjet tregojnë që **nuk ka mekanizëm të vendosur për bashkëpunim** ndërmjet organizatave qytetare/qytetarëve dhe institucioneve në nivel lokal veçanërisht në lidhje me rastet e **mjedisit jetësor**. Komunikimi më së shpeshti është nga rasti në rast apo gjatë krijimit të politikave lokale. Kjo është konfirmuar edhe në grupet e fokusit.

### Kapacitet i institucioneve/organizatave dhe i aktorëve tjerë të cilët punojnë me ndihmë juridike falas

Kjo pjesë e hulumtimit ka të bëjë me kapacitetin e institucioneve/organizatave dhe të aktorëve tjerë (aktivistë civilë, avokatë, shoqata të qytetarëve) të cilët punojnë me ndihmë juridike falas.

Në pyetjen: Deri tani, a keni qenë pjesëmarrës në kontest apo a keni qenë të informuar për kontest (civil, administrativ, penal) pranë organeve kompetente apo gjykatave prë raste lidhur me mjedisin jetësor? (si pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë apo si përfaqësues i organizatës/institucionit nga i cili vini) – përgjigjet janë këto:

- a) po, personalisht, si palë – 1 i intervistuar (3,3%)
- b) po, personalisht, si përfaqësues i institucionit/organizatës nga e cila vij – 3 të intervistuar (10%)
- c) jo, mirëpo kam dëgjuar për raste të tilla – 16 të intervistuar (53,3%)
- d) jo, as nuk kam dëgjuar për raste të tilla – 9 të intervistuar (30%)
- nuk janë përgjigjur – 1 të intervistuar (3,3%)

Përgjigjet për këtë pyetje janë paraqitur në tabelën 9.

TABELA 9: Pjesëmarrës apo informatë për kontest

Deri tani, a keni qenë pjesëmarrës në kontest apo a keni qenë të informuar për kontest (civil, administrativ, penal) pranë organeve kompetente apo gjykatave prë raste lidhur me mjedisin jetësor?	a) po, personalisht, si palë	b) po, personalisht, si përfaqësues i institucionit/organizatës nga e cila vij	v) jo, mirëpo kam dëgjuar për raste të tilla	g) jo, as nuk kam dëgjuar për raste të tilla	Nuk janë përgjigjur	gjithsej
gjithsej	1	3	16	9	1	30
%	3.3%	10%	53.3%	30%	3.3%	100%

Nga përgjigjet rezultojn që vetëm numër i vogël i të intervistuarve (4) kanë përvojë me raste lidhur me mjedisin jetësor. Ky numër vërtetohet edhe nga hulumtime thera për raste gjyqësore të cilat tregojnë numër relativisht të ulët të rasteve të përpunuara në gjykatat e shtetit.

Lidhur me përfundimin, a kanë marrë pjesë apo a kanë qenë të informuar për raste të tilla, përgjigjet janë këto:

a) po, pozitiv për palën – 5 të intervistuar

b) po, pozitiv për institucionin – 4 të intervistuar

v) jo, nuk e di – 20 të intervistuar

Nuk është përgjigjur – 1 i intervistuar

Përgjigjet në këtë pyetje janë paraqitur në tabelën 10.


TABELA 10: Rezultat i kontestit gjyqësor

Nëse keni marrë pjesë apo jeni të informuar për raste të tilla, a e dini përfundimin?	a) po, pozitiv për palën	b) po, pozitiv për institucionin	v) jo, nuk e di	Nuk janë përgjigjur	gjithsej
gjithsej	5	4	20	1	30
%	16.7%	13%	66.7%	3%	100%

Në pyetjen: “A keni shfrytëzuar ju apo a njihni dikë i cili ka shfrytëzuar ndihmë juridike falas për raste lidhur me mjedisin jetësor?” Përgjigje pozitive kanë dhënë 2, negative 27, 1 në pyetjen nuk janë përgjigjur (shih grafikun 18).

Grafiku 18: Shfrytëzim i ndihmës juridike për raste nga sfera e mjedisit jetësor

**Kanë shfrytëzuar ose dinë dikë që ka shfrytëzuar ndihmë juridike për raste që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor**



Këto të dhëna edhe njëherë tregojnë që për raste lidhur me mjedisin jetësor, nuk përdoret **Ligji** për ndihmë juridike falas.

Për të dy raste ku është shfrytëzuar ndihmë juridike falas, në asnjë rast shfrytëzuesi ka qenë i liruar nga shpenzimet gjyqësore ndërsa në një nuk ka qenë (shih tabelën 11).

TABELA 11 Çlirim nga shpenzimet gjyqësore për raste lidhur me mjedisin jetësor

Nëse jeni përgjigjur që keni shfrytëzuar ndihmë juridike, a ka qenë i çliruar prej shpenzimeve gjyqësore shfrytëzuesi?	a) po, kanë qenë të çliruar nga shpenzimet gjyqësore në procedura	b) po, mirëpo jo edhe nga shpenzimet për ekspertizë	Nuk janë përgjigjur	gjithsej
gjithsej	1	1	28	30
%	3.3%	3%	93.3%	100%

Në lidhje me vizitën pjesëmarrjen në trajnime lidhur me aktivitete profesionale nga sfera e **mjedisit jetësor**, përgjigjet janë këto (vërejtje: Mund të rrethoni më tepër se një përgjigje)

- a) po, të organizuar nga Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik – 1 i intervistuar
- b) po, të organizuar nga sektori qytetar – 9 të intervistuar
- c) po, të organizuar prej organizatave ndërkombëtare – 8 të intervistuar

d) jo, mirëpo do të doja – 13 të intervistuar

g) jo, nuk jam i/e interesuar – 2 të intervistuar

këshillim dhe trajnime – 1 i intervistuar

Përgjigjet janë paraqitur në tabelën 12.

TABELA 12 Pjesëmarrje në trajnime

A keni marrë pjesë deri më tani në ndonjë trajnim lidhur me aktivitetet tuaja profesionale nga sfera e mjedisit jetësor?	a) po, të organizuar nga Akademia për gjykatës dhe prokuror publik	b) po, të organizuar nga sektori qytetar	v) po, të organizuar prej organizatave ndërkombëtare	g) jo, mirëpo do të doja	d) jo, nuk jam i/e interesuar
gjithsej	1	9	8	13	2

Edhe me këtë përgjigje vërtetohen informatat që numrin më të madh të trajnimeve lidhur mjedisin jetësor i realizojnë organizata joqeveritare apo organizata dhe institucione ndërkombëtare.

Çfarë njohuri shtesë i mungojnë ekipit të institucionit/organizatës tuaj lidhur me të drejtën për mjedis jetësor të shëndoshë? Mund të rrumbullakoni më tepër se një përgjigje:

a) Më tepër njohuri për mekanizmat ndërkombëtar **për mbrojtjen** e të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë – 3 të intervistuar


b) Njohuri më të madhe për kornizën juridike të shtetit lidhur me të drejtën për mjedis jetësor të shëndoshë – 6 të intervistuar

c) Rritje të kapacitetit të shërbimeve (trajnim të ekipit për sigurim të ndihmës juridike falas në raste të shkeljes së të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë dhe ngjashëm) – 6 të intervistuar

Nuk janë përgjigjur – 3 të intervistuar

Përgjigjet në pyetjet janë paraqitur në grafikun 19.

Grafiku 19 Nevoja për njohuri shtesë




Sipas përgjigjeve, nevojitet njohje më e mirë e kornizës juridike të shtetit lidhur me të drejtën për mjedis jetësor të shëndoshë, si dhe trajnime për rritje të kapacitetit për dhënie të shërbimeve (trajnim i ekipit për sigurim të ndihmës juridike falas në raste të shkeljes së të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë.

Përgjigja në këtë pyetje përputhet me përgjigjen për pyetjen e radhës për nevojat për rritje të diturive për përfaqësim nga sfera e **mjedisit jetësor**?

- a) po, nëse ka trajnime të tilla dëshiroj të marr pjesë – 20 të intervistuar
  - b) po, mirëpo nuk kam kohë – 4 të intervistuar
  - c) jo, nuk punoj në këtë temë – 1 i intervistuar
  - d) jo, kam mjaft njohuri – 2 të intervistuar
  - g) jo – 2 të intervistuar
- Nuk është përgjigjur – 1 i intervistuar

Përgjigjet për pyetjen janë paraqitur në grafikun 20.

Grafiku 20 Nevojë për trajnime shtesë



Si do t'i vlerësoni shkathtësitë Tuaja (individuale) në shkallën nga 1 deri 5 (1 më së paku - 5 më së shumti)

**[a] Ndhmë juridike në përgjithësi]**

1 – 4 të intervistuar

2 – 3 të intervistuar

3 – 8 të intervistuar

4 – 6 të intervistuar

5 – 5 të intervistuar

Nuk kanë dhënë përgjigje – 4 të intervistuar

**.[b] Ndhmë juridike gjatë shkeljes së të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë]**

1 – 7 të intervistuar

2 – 7 të intervistuar

3 – 9 të intervistuar

4 – 4 të intervistuar

5 – 1 të intervistuar

Nuk janë përgjigjur – 2 të intervistuar

Përgjigjet për pyetjen janë paraqitur në tabelën 13.

TABELA 13 Vlerësim i shkathtësive individuale

Si do t'i vlerësonit shkathtësitë Tuaja (individuale) në shkallën nga 1 deri 5	1	2	3	4	5	Pa përgji.	Nota mesat
Ndihmë juridike në përgjithësi	4	3	8	6	5	4	2,77
Ndihmë juridike në raste të shlejs së të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë	7	7	9	4	1	2	2,3

Të intervistuarit i vlerësojnë relativisht mirë shkathtësitë personale edhe për ndihmë të përgjithshme juridike edhe për ndihmë juridike gjatë shkeljes së të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë, me ç'rast shkathtësi pak më të mira kanë në pjesën e ndihmës së përgjithshme juridike. Prapë se prapë, mbetet nevoja për mbindërtim të kapaciteteve të theksuara në përgjigjen paraprake

## Konkluzione dhe rekomandime

Nga përgjigjet për pyetësin, si dhe nga fokus grupet e zbatuara, mund të prezantohen këto konkluzione:

- Informimi i publikut edhe për të drejtat personale, por edhe për obligimet e shtetit lidhur me mbrojtjen e mjedisit jetësor në nivel relativisht të ulët.
- Vetëdija kolektive e qytetarëve për rëndësinë e kontributit personale por edhe të organizuar sistemor drejt mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit jetësor të shëndoshë është në nivel shumë të ulët, përkatësisht pothuaj nuk është i njohur në mesin e qytetarëve. Kjo shpie në situatë kur secili individ pret nga “dikush tjetër” të ndërmarrë iniciativë në lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit jetësor të shëndoshë.
- Numër më i madh i të intervistuarve nuk dinë ku të drejtohen nëse konsiderojnë që kanë rast të shkeljes së të drejtave për mjedis jetësor të shëndoshë.
- Gjatë shkeljes së të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë, veçanërisht kur qytetarët drejtohen në komunat, mungon dituri konkrete nga ana e administratës komunale ku t’i udhëzojnë palët nëse kanë ndonjë problem lidhur me mjedisin jetësor.
- Mungon njohje e kornizës juridike nga ana e organeve shtetërore lidhur me të drejtën për mjedis jetësor të shëndoshë, veçanërisht tek ata aktorë dhe faktorë (shtetërorë, publik, organe gjyqësore etj.) të cilët janë të obliguar të konstatojnë dhe veprojnë edhe për parashtrësive edhe për denoncime.
- Mos identifikimi i kompetencave nga ana e administratës për të vepruar në raste të shkeljes së të drejtës për mjedis jetësor të shëndoshë, kontribuon për besimin e zvogëluar në institucionet nga ana e qytetarëve.
- Numri më i madh i të intervistuarve konsiderojnë që ligjet ekzistuese të vendit lidhur me mbrojtjen e mjedisit jetësor janë relativisht të mira, mirëpo mungon zbatimi i plotë dhe joselektiv i tyre.
- Rrjedhimisht, 73.3% nga të intervistuarit konsiderojnë se qytetarëve nuk u është mundur qasje në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor nëpërmjet mekanizmave ekzistues për qasje në drejtësi.
- Të intervistuarit konsiderojnë që nuk ka standardizim të ligjeve dhe procedurave, me ç’rat për lëndë të ngjashme miratohen vendime të ndryshme, nuk ka praktikë të harmonizuar gjyqësore, me çka rritet mosbesimi i qytetarëve në gjyqësor si dhe në organet dhe institucionet tjera shtetërore, kurse gjatë kësaj taksat dhe shpenzimet gjyqësore për ekspertizë janë tepër të larta.
- Të intervistuarit, mungesën e praktikës gjyqësore për lëndë nga fushat e mjedisit jetësor e detektojnë në gjyqtarët pamjaftueshëm të përgatitur të cilët nuk dinë si të veprojnë në rast të kontestit nga sfera e mjedisit jetësor.



- Qytetarët përgjithësisht vështirë arrijnë të të dhëna apo ndonjë informatë konkrete nga institucionet lidhur me çështje të mjedisit jetësor dhe për të arritur të ndonjë informatë qytetarëve u nevojitet edhe kohë edhe mjete të konsiderueshme për të marrë informatën e duhur dhe të dëshiruar.
- Numër shumë i vogël i të intervistuarve kanë dëgjuar apo janë të njoftuar me Konventën e Aarhusit, si dhe për standardet dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtar të cilat i ka ratifikuar shteti në sferën e mjedisit jetësor.
- Bashkëpunimi ndërmjet sektorit joqeveritar dhe institucioneve publike është në nivel shumë të ulët dhe nevojitet vendosje e kanaleve të rregullta të komunikimit dhe shkëmbim i informatave.
- Është identifikuar nevoja për rritje të numrit të debateve tematike publike për gjendjen me mjedisin jetësor veçanërisht për çështje të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi jetën dhe shëndetin e njeriut (shkatërrimi i pyjeve, problemi me rrëshqitjet e dheut, autostradat me ndërtimin e të cilave shkatërrohen zonat malore, minimet joadekuate në Kozjak me çka është rrezikuar burimi Treska. Debate të rregullta janë të nevojshme për temat në vijim: planifikim hapësinor, miniera, ajri, shëndeti i njerëzve dhe ndotja, riciklimi i hedhurinave).
- Nevojiten debate të rregullta publike për ngritje të vetëdijes ekologjike edhe atë duke filluar me moshën më të re për rëndësinë e mjedisit jetësor dhe mbrojtjen e vet veçanërisht për rëndësinë e mjedisit jetësor, planifikimin hapësinor, minierat, ajrin, shëndetin e njerëzve, riciklimin e hedhurinave...
- Numër i vogël i të intervistuarve kanë marrë pjesë në trajnime nga fusha e mjedisit jetësor, të cilat kryesisht kanë qenë të organizuara nga sektori joqeveritar, ndërsa ekziston interes i madh për atë.
- Ka nevojë për mbindërtim të diturive për përfaqësim nga fusha e mjedisit jetësor dhe shfrytëzim të mekanizmave në dispozicion që rezultojnë edhe nga dokumentet ndërkombëtare, por edhe nga legjislacioni vendas që është në fazë të harmonizimit me standardet ndërkombëtare.

## Rekomandime:

Në bazë të hulumtimit, fokus grupet e realizuara dhe analiza e përgjigjeve në pyetësor, mund të përmbliken këto rekomandime:

- ✓ Ka nevojë për ngritje të vetëdijes së përgjithshme në nivel lokal dhe nacional për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe ndikimin e vet mbi shëndetin dhe jetën e njerëzve.
- ✓ Qëndrueshmëria e politikave dhe ngritja e vetëdijes së popullatës në lidhje me mjedisin jetësor, në plan afatgjatë mund të realizohet nëpërmjet inkorporimi të arsimit të përgjithshëm për mjedis jetësor në të gjitha shkallët e arsimit.
- ✓ Nevojitet njoftim i publikut më të gjerë me Konventën e Aarhusit, por edhe me standardet dhe mekanizmat ndërkombëtarë **për mbrojtje të** mjedisit jetësor me ratifikimin e të cilave shteti jonë është obliguar t'i implementojë, zbatojë dhe respektojë në drejtim edhe të mbrojtjes së mjedisit jetësor, por edhe të mbrojtjes së shëndetit dhe jetës edhe të njerëzve edhe botës bimore.
- ✓ Publikim i rregullt i informatave të cilat i prekin qytetarët në lidhje me mjedisin jetësor, planifikimin urbanistik dhe hapësinor, në mënyrë të saktë, të shpejtë dhe lehtë të arritshme për qytetarët e interesuar duke i shfrytëzuar teknologjitë dhe veglat bashkëkohore.
- ✓ Respektim i zgjidhjeve dhe dispozitave ligjore edhe nga ana e institucioneve që duhet të japin llogari nëse në mënyrë të paarsyetuar deklarohen si jokompetente për ndonjë çështje të caktuar për të cilën kanë pasur për detyrë të japin përgjigje/informatë.
- ✓ Rritje e kapaciteteve të institucioneve shtetërore në aspekt të fuqizimit të resurseve njerëzore të cilat punojnë me palë dhe të cilat kanë kompetencë t'u japin informata subjekteve të interesuara nga sfera e mjedisit jetësor, me çka do të ishte zmadhuar profesionalizmi dhe dituria e tyre, kurse me atë edhe besimi i qytetarëve në institucionet.
- ✓ Gjendje të mekanizmave për ndërmarrje të masave konkrete nga ana e organeve dhe institucioneve shtetërore në drejtim të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe informim të publikut për atë.
- ✓ Trajnime të detyrueshme dhe edukim të gjykatësve, avokatëve, inspektorëve, ekspertëve si dhe organeve dhe institucioneve tjera kompetente për të vepruar për çështje dhe probleme nga sfera e mjedisit jetësor me çka do të kontribuohet edhe për standardizim të ligjeve dhe praktikës gjyqësore.
- ✓ Trajnime për të gjitha palët e interesuar për njoftim me obligimet që i ka shteti, ndërsa të cilat rezultojnë nga dokumentet e ratifikuara ndërkombëtare dhe për respektimin e të drejtave të njeriut dhe qasje në drejtësi si dhe **për mbrojtje të mjedisit jetësor**.
- ✓ Trajnime të specializuara për përfaqësues të sektorit joqeveritar për përfaqësim lidhur me çështje që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor.

- ✓ Trajnime të specializuara për administratën nga ministritë për mundësitë që rezultojnë nga Konventa e Aarhusit për qasje tek informatat dhe drejtësi për çështje lidhur me mjedisin jetësor.
- ✓ Trajnim për monitorim, analizë dhe vlerësim të gjendjes së mjedisit jetësor dhe njoftim për gjendjen edhe për persona privat edhe për përfaqësues të sektorit joqeveritar.
- ✓ Zvogëlim të shumës së taksave gjyqësore, por edhe zvogëlim të shpenzimeve për procedurat, veçanërisht për parashtrësia të grupeve të interesit publik (shembul ndotje e ajrit) me qëllim të mundësohet qasje në drejtësi për të gjithë qytetarët në shtet.
- ✓ Vendosje dhe përkufizim i qartë i ingerencave të të gjitha organeve shtetërore dhe lokale të cilat janë kompetente për të vepruar për çështje nga sfera e mjedisit jetësor, si dhe fuqizim i domosdoshëm i kapacitetit të të njëjtave.
- ✓ Fuqizim i bashkëpunimit ndërmjet sektorit qeveritar dhe joqeveritare për çështje lidhur me mjedisin jetësor. Njëri nga aktivitetet e përbashkët mund të jetë edhe mbajtja e debateve publike të rregullta dhe tematike në pjesën e mjedisit jetësor, me hapje të diskutimeve për të gjitha çështjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve.

\*\*\*\*\*

Edhe përkrah asaj që pyetësori është përgjigjur nga numër relativisht të vogël të të intervistuarve (30 të intervistuar), ekipi hulumtues vlerëson që përgjigjet dhe rekomandimet që rezultojnë nga përpunimi i pyetësorit, japin udhëzim të mirë edhe për reforma efektive për qasje në drejtësi në sferën e mjedisit jetësor në pajtim me Konventën e Aarhusit dhe standardet e Bashkimit Evropian, si dhe për ndërtim të kapaciteteve të bartësve të proceseve reformuese për obligimet që burojnë nga legjislacioni ndërkombëtar dhe vendas për qasje efektive në drejtësi për rastet nga fusha e mjedisit jetësor.

## Literatura e konsultuar për obligimet edhe të shtetit edhe të qytetarëve në lidhje me mjedisin jetësor

1. Konventa e Aarhusit
2. Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të RMV-së
3. Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën: *Udhëzues për zbatimin e Konventës së Aarhusit*, 2000.
4. Ligji për ndihmë juridike falas, neni 13, paragrafi 1, "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 101, datë 22.05.2019
5. Ligji për procedurë civile (Gazeta Zyrtare e RM" nr. 7 datë 20.01.2011)
6. Ligji për parandalim dhe mbrojtjen nga diskriminimi "Gazeta Zyrtare e RM" nr.50 datë 13.04.2010
7. Ligji për parandalim dhe mbrojtjen nga diskriminimi "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 101, datë 22.05.2019
8. Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore
9. Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore
10. Ottavio Quirico and Mouloud Boumghar (eds.): *Climate change and human rights: an international and comparative law perspective*
11. Reporteri i KB për të drejtat e njeriut dhe mjedisin jetësor <https://www.ohchr.org/EN/Issues/Environment/SREnvironment/Pages/SREnvironmentIndex.aspx>
12. Regjion nën administrim të Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Sigurimit, rezoluta 1244 (1999)
13. Deklarata universale e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut
14. Dekreti për strategjitë, planet dhe Programet, duke i përfshirë edhe ndryshimet e atyre strategjive, planeve dhe programeve, për të cilat detyrimisht realizohet procedurë për vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis dhe në jetën e shëndetin e njerëzve (Gazeta Zyrtare nr. 153 / 2007 dhe 45/2011).
15. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (SVRM 52/1991, SVRM 1/1992, SVRM 31/1998, SVRM 91/2001, SVRM 84/2003, SVRM 107/2005, SVRM 3/2009 I SVRM 49/2011